



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1087 prot.

Roskovec, më 10.02 2024

VENDIM

NR 10 .DATË 19.02 .2024

**“PËR FALJEN E TARIFËS PËR MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS SË  
UJITJES DHE KULLIMIT PËR VITIN 2024 PËR FERMERËT TË CILËT JANË  
ANËTARË TË ODËS SË BUJQËSISË”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Neni 27 Pika 1, Neni 54 gërma f ,të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 35, pika 2, si dhe në rëndësinë që ka për zhvillimin e bujqësisë lokale ndërmarja e këtyre nismave; Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

1. Faljen e tarifës për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit për vitin 2024 për fermerët të cilët janë anëtarët e krijimit të Odës së Bujqësisë, si dhe antarët e rinj që kanë firmosur deklaratën e antarësisë sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore ,Sktori i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Ndërmarrja e Pyjeve,Ujitjes e Kullimit dhe Mirëmbajtje Rrugë dhe Varreza për zbatimin dhe ekzekutimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Blaka

